


**PERMBLEDHJE E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER  
AKTIVITETIN PRODHIM VERE TE SUBJEKTIT FLORETA SADE**

Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit, ky aktivitet, perfshihet ne listat e aktiviteve te cilat duhet te paisen me Leje Mjedisore te Tipit B, (Pika 7.7/h. Prodhimi i alkolit dhe pijeve alkoolike duke perfshire dhe fabrikat e birres” (shtojca 1 e Ligjit Nr.10448, date 14.07.2011”Per Lejet e Mjedisit”, ndryshuar me Ligjin Nr.60/2014)



**ADMINISTRATORE : FLORETA SADE**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Floreta Sade', written over the printed name.

## PERMBAJTJA E LENDES

### HYRJE

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR
2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.
3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.
4. PËRSHKRIMI I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.
5. INFORMACIONI PËR KOHËZGATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.
6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS
7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.
8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGJEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.
9. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.
10. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGJEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

## **HYRJE**

Objekti i vlerësimit te ketij raporti eshte aktiviteti i prodhimit te pijeve alkoolike, konkretisht Veres se kuqe, Veres se bardhe , te cilat jane edhe pijet tradicionale te vendit tone. Prodhimi i veres dhe i rakise do te realizohet me metodat tradicionale te fermentimit te mushtit dhe prodhimit te pijes alkoolike ne cilesine dhe fortesine e kerkuar ne treg. Nga aktiviteti nuk ka mbeqje te trezikshme, nuk ka shkaktime te ujrave industriale dhe shkaktime te lendeve ndotese ne ajer.. Mbeqjet e ngurta te mushtit (bersiave te rrushtit) jane planifikuar te perdoren per pleherim organik ne fushen e bujqesise. Per keto mbeqje ka kerkesa nga fermeret e zones.

Ky aktivitet do te zhvillohet ne ambientet private te subjektit. Objekti ndodhet ne Fshatin Selitre te njesise Administrative Mollas, Bashkia Cerrik, rrethi Elbasan. Sipërfaqja e gjithë ambientit është rreth 148m<sup>2</sup>. Ne keje ambiente do te zhvillohet aktiviteti i shtypjes se rrushtit me makineri me procese mekanike te ndarjes se kokrrave nga kercelli, depozitimi ne vaskat dhe rezervuaret e veres pra ruajtja e mirembajtja e mushtit deri ne fermentimin e plote te tij dhe prodhimin e veres dhe apo rakise. Po keshthu, pas fermentimit te rrushtit, do te hidhet ne kazamin e zierjes se rakise dhe pas prodhimit te saj nepernijet procesit te kondensimit e distillimit, do te ambalazhohet ne shishe qelqi apo plastike sipas kerkesave.

## **1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR**

### **Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM**

Ky Raport i Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor per VNM dhe ka per qellim qe te parashikojë, identifikojë, vleresojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin ne mjedis te projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) Procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) Procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit mund të jetë:

- a) Raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011;
- b) Raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës i te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011;

Objektivat afatshkurter te VNM jane:

- Permitresim nga pikepamja mjedisore te projektit te propozuar;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me efjence;
- Siguron qe eshte perzgjedhur alternativa me e mire e vendodhjes se projektit.
- Siguron qe jane marre ne konsiderate teknikat me te mira te Disponueshme te teknologjise se propozuar per tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit te propozuar;
- Mundeson informimin e vendim-marresve, duke gjykuar ne miratimin ose jo te projektit dhe kushteve qe duhet te vendosen ne aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e paktyeshme te mjedisit;
- Ndikon ne mbrojte burimeve natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permbledon aspektet sociale-ekonomike te projektit
- Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit.

#### **Sqarim:**

Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit, ky aktivitet, përfshihet ne listat e aktiviteteve te cilat duhet te paisen me Leje Mjedisore te Tipit B, (Pika 7.7./h. Prodhimi i alkolit dhe pijeve alkoolike duke përfshire dhe fabrikat e birres” (shtojca 1 e Ligjit Nr.10448, date 14.07.2011”Per Lejet e Mjedisit”, ndryshuar me Ligjin Nr.60/2014) **por nuk klasifikohet tek aktivitetet te cilat kane nevojte ti nenshtrohen procedures se VNMM Paraprake apo te thelluar.**

Kjo permbledhje e Vleresimi te Ndikimit ne Mjedis, hartohet per te informuar publikun dhe institucionet e mbrojtjes se mjedisit mbi ndikimet ne mjedis te aktivitetit.

#### **Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin**

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar ndofjen dhe demtimin e komponenteve te vecante dhe te rendesishem te mjedisit nga faktore te ndryshem, njerzore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore ne lidhje me kete projekt, mund te përmendim:

- **Ligji Nr. 10431 date 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.**
- **Ligji Nr. 10440 date 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.**
- **Ligji Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”.**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”.**
- **Ligji Nr.9587, date 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.**
- **Vendim Nr. 123, date 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”.**
- **Vendim Nr. 313, date 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarimet ne mjedis”.**
- **Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.**
- **Vendim Nr. 247, date 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”.**
- **Udhezim Nr. 8, date 27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmave.**

#### **Kapacitetet perpunuese dhe tregtuese**

Kantina ka nje kapacitet prodhimi 40-50 Hl ne vit. Prodhimi i trushit arrin deri 8 ton ne vit.

Sipërfaqja e kantines eshte 1 m<sup>2</sup>.

Vera prodhohet nga rrushi i varieteteve, Kabernet, Shesh i zi dhe Shesh i bardhe, Tokai dhe Merlot, krahs saj perdoret dhe dhe rrush muskat hamburger, vranec dhe smedern dhe ploteson kerkesat agro-mjedisore qe kerkon ky sistem prodhimi. Materjalet qe perdoren nuk jane te demshme per shendetin e njerzëve, gjallesave dhe mjedisin ne pergjithesi

Disa karakteristika te teknologjise bujqesore te perdorrur jane:

- Elementet ushqyese të hardhise dhe tokes sigurohen nga përdorimi i plehrave organike. Në këte vresht nuk përdoren plehra kimike tradicionale.
- Mbrojtja e hardhise dhe rrushit nga semundjet dhe dëmtuesit sigurohet nga përdorimi i pesticideve të regjistruara për prodhime bio.
- Uji për vadije sigurohet nga sistemi i vadijes të Bordit të kullimit.
- Vreshti është i rrethuar nga sipërfaqe toke bujqesore e cila e mbron atë nga ndotjet në formë pluhuri ose tymi
- Në sipërfaqen përreth vreshtit ka kafshë dhe shpend që mbareshohen nga familjet fermere (tipike për zonat rurale)

### **Kushdet teknologjike të kantine**

Termi kantine ka të bëjë me pëshkrimin e vendit ku bëhet vera, fermentohet dhe stazhionohet ose vjetrohet.

### **Karakteristika të përgjithshme**

Kantina është e vendosur dhe është e ndërtuar në mënyrë të atillë që siguron standarde si: është në një vend të mbrojtur dhe të ajrosur, të thatë, të errët, jo i zhurmshëm, pa tronditje dhe lëkundje dhe pa aroma përreth.

### **Lagështira e kantine**

Mbi bazën e eksperiencave, vlera e lagështisë relative të kantine mbahet 70-80% dhe në periudhën me lagështi mbi 80%. Në fakt në shishen që konservohet gjithmonë në pozicion horizontal, nga njëra anë e tapës është vera dhe lagështia 100%, kurse nga ana tjetër është ambienti që duhet t'i përshtrahet kësaj vere deri në kohën kur vera nuk ka dalë nga shishja.

### **Temperatura në kantine**

Temperatura në kantine mbahet konstante gjatë viteve të ruajtjes, pasi ndryshime të vogla të saj do të ishin tepër të dëmshme për verën. Energjia e akumuluar si pasojë e ndryshimit të temperaturës, mund të provokojë agregimin dhe precipitim të polifenoleve (antocianet dhe taninet) që janë substancat ngjyuese tek vera.

Ndërkohë, mbledhja dhe zgjerimi shtypin dhe ngrenë lart tapën e shishes, duke ulur shkëmbimin e ajrit dhe si rrjedhim oksidimin.

Nga eksperiencia është arritur në përfundimin që temperatura optimale për verërat e kuge është 12-14°C dhe për verërat e bardha kjo temperaturë është 10-12°C.

### **Ndriçimi në kantine**

Ambienti i kantine është i errët. Ashtu si edhe temperatura, dita është energji dhe ndikon në precipitim të polifenoleve, si rrjedhim ndriçimi ndikon edhe në vjetrimin e shpejtë të verës.

## **Aroma në kantine**

Vera ka aftësinë për të absorbuar aromat apo erërat që e rrethojnë të çfarëdo materiali dhe të çfarëdo përbërje kimike. Pra, është ne vëmendjen e stafit teknik te kantines evitimi i prezencës se aromave të pa dëshirueshme. Në kantine evitohen depozitimet e çfarëdo materiali me natyrë kimike: si gazi e benzina, kuti bojërash, sapunë, etj, prania e ushqimeve si: djathi, qepa, etj., që kanë aromë të rëndë.

## **Sistemi në rafte i shisheve të verës**

Metoda më e mirë për sisteminin e shisheve të verës është duke përdorur rafte prej druri. Për të gjitha verërat me pak përjashime, pozicioni i konservimit nëpër rafte është horizontale, me etiketën gjithmonë për lart.

## **Enët dhe kategorizimi i tyre**

Enët më të rëndësishme që përdoren në kantine janë ato prej inoksi (qelk inoksidabël) këto enë janë kryesisht enë fermentimi.

Në kantine përdoren dhe ene per te mare mostra per analize si gypa qelqi që vendosen në anë të enëve të fermentimit të cilat shërbejnë për të treguar sasinë e lëndës që ndodhet në fermentim, por përdoren edhe enët prej druri të cilat përdoren kryesisht për maturimin e verërave. Pra kemi enët e fermentimit, enët e maturimit dhe enët ndihmëse.

Një pjesë e enëve të cilat përdoren janë edhe enët ambalazhuese të cilat janë kryesisht enë qelqi. Zakonisht zgjidhen shishe prej qelqi të errët ose të turbullt për verërat e kuqe, të cilat duhet të mbrohen nga veprimi i dritës. Krahas tyre per veren përdoren dhe bakin bokset 3 dhe 10 litroshe

Ndër llojet e shisheve më të përdorura eshte shishja tipike për verërat e kuqe, me ngjyrë dhe nxënësi 750 ml;

## **Taposja**

Pas mbushjes së verës në shishe bëhet taposja e tyre. Kantina perdor tapat tipike të drurit, të sterilizuara. Tapat qe përdoren ne kantine jane cilësore dhe prodhohen në vendet perendimore (Spanje, Itali, France). Perpara taposjes tapat mbahen për disa kohë në ujë të ftohtë me anhidrid sulfuror ose zbuten me ujë që vlon ose avull.

Taposja kryhet me makinat që lejojnë fuqjen e tapës me presion duke bërë që ajri mbetet në qafën e shishes te dalë jashtë.

Nje paisje tjeter siguron vendosjen e kapsulave te kallajit dhe ngjitin edhe etiketën. Shishja në përgjithësi konfeksionohet me një etiketë kryesore ose etiketa e trupit

**Për prodhimin e rakisë** së trushit me cilësi të mirë organoshtesore( ne se do te prodhohet), kërkesë kryesore përveç cilësisë së lëndës së parë, është largimi i pjesëve të druqëzuara të trushit (frenjave).

Kur fermentimi alkoolik kryhet në prani të frenjave përmbajtja e lëndëve tanike rritet shumë në leng dhe ato i japin rakisë shije të hidhur të theksuar.

Rrushni për prodhim rakie përpunohet sipas disa proceseve teknologjike të ndryshme për përfundimin e materialeve të fermentuara për distilim.

Materiali i lengut (leng+benisi) për prodhim rakie duhet të ketë këto karakteristika: përmbajtja e alkoolit etilik 8-9% vëllim, aciditeti i përgjithshëm jo më pak se 7 g/l, ekstrakti i përgjithshëm jo më i lartë se 18g/l, aciditeti fluoror si acid acetik jo më tepër se 1,5 g/l.

Kantina është në katin e poshtëm të ndërtesës dhe perbehet nga disa sektore si

- Sektori i pritjes së rushit
- Sektori i fermentimit të pare dhe të dyte
- Sektori i ruajtjes dhe staxhionimit
- Sektori i ambalazhimit
- Magazina e produktit
- Mini laboratori
- Per te ardhmen është parashikuar dhe sektori i distilimit të rakisë.

Kantina është e ndërtuar me themele guri dhe veshje me gur. Mbulesa e saj është me solete. Dyshemeja është e shtruar me pllaka gres të cilësise së mire dhe dritaret janë prej duralumini.



Foto: Pamje e bredneshme dhe e jashtme e kantines së veres

## **Kushtet teknologjike të “Kantines”**

Termi kantineë ka të bëjë me përshkrimin e vendit ku bëhet vera, fermentohet dhe stazhionohet ose vjetrohët.

### **Karakteristika të përgjithshme**

Kantina është e vendosur dhe është e ndërtuar në mënyrë të atillë që siguron standarde si: është në një vend të mbrojtur dhe të ajrosur, të thatë, të errët, jo i zhurmshëm, pa tronditje dhe lëkundje dhe pa aroma përreth.

### **Lagështira e kantineës**

Mbi bazën e eksperiencave, vlera e lagështisë relative të kantineës mbahet 70-80% dhe në periudhën me lagështi mbi 80%. Në fakt në shishen që konservohet gjithmonë në pozicion horizontal, nga njëra anë e tapës është vera dhe lagështia 100%, kurse nga ana tjetër është ambienti që duhet t'i përshatet kësaj vere deri në kohën kur vera nuk ka dalë nga shishja.

### **Temperatura në kantineë**

Temperatura në kantineë mbahet konstante gjatë viteve të ruajtjes, pasi ndryshime të vogla të saj do të ishin tepër të dëmshme për verën. Energjia e akumuluar si pasojë e ndryshimit të temperaturës, mund të provokojë agregimin dhe precipitimin e polifenoleve (antocianet dhe taninet) që janë substancat ngjyruese tek vera.

Ndërkohë, mbledhja dhe zgjerimi shtypin dhe ngrenë lart tapën e shishes, duke ulur shkëmbimin e ajrit dhe si rrjedhim oksidimin.

Nga eksperiencia është arritur në përfundimin që temperatura optimale për verërat e kuge është 12-14°C dhe për verërat e bardha kjo temperaturë është 10-12°C.

### **Ndricimi në kantine**

Ambienti i kantineës është e errët, ashtu si edhe temperatura, drita është energji dhe ndikon në precipitimin e polifenoleve, si rrjedhim ndricimi ndikon edhe në vjetrimin e shpejtë të verës.

### **Aroma në kantineë**

Vera ka aftësinë për të absorbuar aromat apo erërat që e rrethojnë të çfarëdo materiali dhe të çfarëdo përbërje kimike. Pra, është në vëmendjen e stafit teknik të kantineës evitimi i prezencës së aromave të pa dëshirueshme. Në kantine evitohen depozitimet e çfarëdo materiali me natyrë kimike: si gazi e benzina, kati bojërash, sapunë, etj, prania e ushqimeve si: djathi, qepa, etj., që kanë aromë të rëndë.

### **Sistemimi në raftë i shisheve të verës**

Metoda më e mirë për sistemimin e shisheve të verës është duke përdorur raftë prej druri. Për të gjitha verërat me pak përjashtime, pozicioni i konservimit nëpër raftë është horizontal, me etiketën gjithmonë për lart.

### **Enët dhe kategorizimi i tyre**

Enët më të rëndësishme që përdoren në kantine janë ato prej inoksi (gelik inoksidabël) këto enë janë kryesisht enë fermentimi.

Ne kantine perdoren dhe ene per te mare mostra per analize si gypa qelqi që vendosen në anë të enëve të fermentimit të cilat shërbejnë për të treguar sasinë e lëndës që ndodhet në fermentim, por përdoren edhe enët prej druri të cilat përdoren kryesisht për maturimin e verërave. Pra kemi enët e fermentimit, enët e maturimit dhe enët ndihmëse.

Një pjesë e enëve të cilat përdoren janë edhe enët ambalazhuese të cilat janë kryesisht enë qelqi. Zakonisht zgjidhen shishe prej qelqi të errët ose të turbullt për verërat e kuqe, të cilat duhet të mbrohen nga veprimi i dritës.

Ndër llojet e shisheve më të përdorura ne kantinën "BIO HOLTA" është shishja "bordoleze" që është edhe shishja tipike për verërat e kuqe, me ngjyrë dhe nxënësi 750 ml;

### **Taposja**

Pas mbushjes së verës në shishe bëhet taposja e tyre. Kantina perdor tapat tipike të drurit, të sterilizuara. Tapat që perdoren ne kantine jane cilësore dhe prodhohen në Spanjë. Perpara taposjes tapat mbahen për disa kohë në ujë të ftohtë me anhidrid sulfuror ose zbuten me ujë që vlon ose avull.

Taposja kryhet me makinat që lejojnë fuqjen e tapës me presion duke bërë që ajri mbetet në qafën e shishes te datë jashtë.

Nje paisje tjeter siguron vendosjen e kapsulave te kallajit dhe ngjithin edhe etiketën. Shishja në përgjithësi konfeksionohet me një etiketë kryesore ose etiketa e trupit

**Për prodhimin e rakisë** së rrushit me cilësi të mirë organoshqisore, kërkesë kryesore përveç cilësisë së lëndës së parë, është largimi i pjesëve të druqëzuara të rrushit (frenjave).

Kur fermentimi alkoolik kryhet në prani të frenjave përmbajtja e lëndëve tanike rritet shumë në leng dhe ato i japin rakisë shije të hidhur të theksuar.

Rrushti për prodhim rakisë përpunohet sipas disa proceseve teknologjike të ndryshme për përfundimin e materialeve të fermentuara për distilim.

Materiali i lengut (leng+bersi) për prodhim rakisë duhet të ketë këto karakteristika: përmbajtja e alkoolit etilik 8-9% vëllim, aciditeti i përgjithshëm jo më pak se 7g/l, ekstrakti i përgjithshëm jo më i lartë se 18g/l, aciditeti fluor si acid acetik jo më tepër se 1,5 g/l.

## **2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.**

Aktiviteti ne vleresim është prodhim i veres dhe rakisë nepermjet metodës tradicionale, me paisje bashkekohore. Objekti ndodhet ne Bashkine Certik, Njesia Administrative Mollas, Fshati Selite, Zona Kadastrale Nr.3294, me Nr. Pasurise 3/18, objekt privat.

Objekti nuk prek bimesine e zones, permendim se kjo zone është zone rurale dhe objekti është ndertuar i ri dhe është ne proces legalizimi

Zona kadatrrale 3294, Numuri pasurise 3/18-siperfaqe 148m<sup>2</sup>.

Kufizimet V-3/17; L-179; J-3/19; P-3/18

### **Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit.**

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarin e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar një ligj mbi te cilin të mbeshetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave.

Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtraret me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbeshetet në kategoritë menaxhuese të Qëndrës Nderkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar “Mali i Tomorit” në Berat. Në vitin 1956, në mbeshetje të Dekretit “Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë” u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull.

Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të tralla e të veçanta natyrore, shkencore, shogërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekreten e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të tralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

### **Lagunat Bregdetare**

Lagunat bregdetare ose tokat e lagura në bregdet janë ekosistemet më të rëndësishëm të biodiversitetit shqiptar dhe për vlerat socioekonomike që ofojnë. Vetëm në rreth 3% të sipërfaqes së vendit që mbulohet nga këto zona, përmbilidhet rreth 70% e llojeve të ruazoreve të vendit. Ato paraqiten si një zinxhir që përshkon të gjithë vijën bregdetare ku përmendim nga veriu në jug Velipojën, sistemin e Kune-Vainit, Parokun, Rrushkullin, Karavastanë, Nartën, Orikumin, Butrintin, etj. Veçanërisht të rëndësishme shfaqen ato për grupin e shpendëve, kryesisht për dimërimin e shpendëve shëgtarë të ujit, dhe të amfibëve duke u ndjekur nga reptilët dhe gjitarët.

### **Rëndësia e Shqipërisë për llojet shtegtare**

Shqipëria është një udhëkryq i rëndësishëm për migrimin e shpendëve, lakurigve të natës dhe insekteve. Çdo vit takohen rreth 70 lloje shpendësh uji me një popullatë totale prej 180.000 individësh në Shqipëri gjatë dimrit. 2 nga 9 llojet e shpendëve endemikë Europianë janë gjithashtu prezent në vendin tonë (Trishili me mustaqe dhe Thellëza e Malti). Gjithashtu 5 lloje të rrezikuara shpendësh takohen në Shqipëri si Pelikani kaqurel,

Pata ballëbardhë, etj. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brëndësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratorë. Së paku katër prej këtyre ligatinave (Laguna e Karavastasë, Laguna e Nartës, Ligani i Shkodrës dhe ai i Ohrit) mund të konsiderohen si Zona të një

Rëndësie Ndërkombëtare për shpendët, të njohura me emrin IBA (Important Bird Area), dhe plotësojnë kushtet për të qënë si zona Ramsar (Karavastaja, Butrinti dhe Shkodra janë shpallur të tilla), me më shumë se 20,000 mijë shpendë dimëronës uji secila.

Shqipëria si një vend mesdhetar i pasur me gëlqerorë dhe shpella, ofron varietete habitatesh që mund të përdoren si vende jetese për lakuriqët e natës. Rreth gjysma e llojeve të gjetaura të lakuriqëve të natës njihen si lloje që jetojnë në shpella. Tynelot e ndërtuara në kohët e shkuara për qëllime ushtarake dhe shumica e minierave që nuk përdoren më, janë vende të vlefshme për lakuriqët e natës. Disa nga këto janë tashmë të populluara nga kolonitë e lakuriqëve të natës.

**Njesia Administrative e Mollasit.** Mollasi qendër e krahinës së Sulovës. Lugina ndodhet në lartësi 70-150m mbi nivelin e detit dhe është me origjinë sedimentare e kuaternari.

Larmishmëri dhe strukturë peisazhore paraqet Dasari. Dasari i vendosur në një terren fushor-kodrinor, përrënj, kodrina të valëzuara me copëtime, ka një karakter të shpërndarë. Prania e larmisë së tokave ka kushtëzuar edhe bimësinë, si atë natyrore dhe atë të kultivuar. Bimësia e luginës përbëhet kryesisht nga dushqet dhe më pak nga shkurretat mesdhetare, këto të fundit më të pranishme përgjatë grykës së Devollit. Në zonën e shkurreve (1000 m) dallohen dushqet (gj. *Quercus*) shkoza (*Carpinus* sp.), Thana (*Cornus mas*) lajthia (*Corillus avellana*), dëllinja (*Juniperus* sp.), Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus* L.), **Kulpra** (*Clematis vitalba* L.) dhe shpesh bushit (*Buxus sempervirens*) marea (Arbutus unedo), shqopa (*Erica arborea*). Në drejtim të lindjes shkurret mesdhetare bëhen më të tralla, dhe llojet gjithnjë të blerta zëvendësohen nga llojet gjetherënëse.

Pjesë e konsiderueshme dhe me mjaft vlera natyrore dhe ekonomike është bimësia shkurre – drunore e kultivuar (jo më pak prezente dhe e rëndësishme është bimësia bujqësore, perimore, foragjere) si arrat (Gj. *Junglans*), Qershitë (Gj. *Cerasus* sp.), shegë (Gj. *Punica* sp.), mollët (Gj. *Malus* sp.), lajthitë (Gj. *Corillus*), dardhat (Gj. *Pirus* sp.), kumbullat (Gj. *Prunus*), pjeshkë, kajsi (*Armeniaca vulgaris*), hardhitë (Gj. *Vitis* sp.), etj.

Jo më pak e larmishme është dhe fauna tipike për zonatitete bimore sikurse dhelpra, lepuiri, shpendë të fushave dhe maleve (Gj. *Accipiter*, Gj. *Corvus*, Gj. *Pirrohovorax*, Gj. *Falco*, Gj. *Scrolopacides*, Gj. *Aquila*, Gj. *Alectoris*, Gj. *Hindinidea*, etj), zvarranikë të shumtë, etj. Ndërkohë që mjaft e zhvilluar është fauna e kultivuar sikurse janë tufat e dheneve e dhive, derrat, lopët, pulat,

### **3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.**

Ne zonën e zbatimit të këtij projekti ka burime ujore të identifikuara. Keto burime ujore nuk ndodhen në pronen/sipërfaqen në vlerësim, por në një distancë të caktuar sipas përkrahimit të meposhtem. Zona është me relief kodrinor dhe nuk ndodhet në brendësi të burimeve ujore të rëndësishme si Lumenjtë Kryesore, Ligene, Rezervuare, Laguna apo zona Bregdetare. Në këto zone, nuk identifikohet burime ujore të tjera të rëndësishme përveç Lumit Devoll i cili kalon në veriperëndim të objektit rreth 500m në vijë ajrore.

**Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.**

Në këto zone ku ushtrohet aktiviteti nuk ka zona të mbrojtura përfshi dhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

## **Gjendja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca**

Bazuar në VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe Procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar për monitorimin e mjedisit”, MM nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Institutit të Shëndetit Publik Vepirintaria studimore e monitoruese, është fokusuar në realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Vlerësimi dhe studimi i treguesve mjedisorë të gjendjes dhe ndikimit në mjedis
- Realizimi i monitorimit të cilësise së ajrit në Shqipëri, në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

Per zone ne fjale, fshati Selite dhe Njesine Administrative Mollas, nuk ka studime lidhur me Indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit, LNP, PM10, NO2, SO2, Pb, O3, CO dhe BTEX qe përfaqësojnë treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së tij, mbështetur në udhëzimet e BE-së dhe të refi ektuara edhe në VKM nr. 803, datë 4.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”.

Sipas hulumtimeve në terren, mbështetur në metoda alternative vlerësimi apo duke përdorur njësi ekuivalente kohë/funksion rezulton se në zonat rurale dhe pikërisht ne kete zone, cilësia e ajrit është e mirë dhe shumë e mirë.

## **Përmbajtja e ndotësave të gaztë (NO2, SO2)**

Në vlerësimin e cilësisë së ajrit urban, rëndësi të veçantë ka përmbajtja e gazeve, nivelet e larta të të cilave janë me pasoja të rëndësishme për shëndetin dhe për mjedisin. Ne kete zone nuk ka kryerje te monioitrimit te ketyre gazrave

## **Ndotësit Fotokimik**

Në shumë mjedise urbane ndotësit fotokimike janë bërë burime kryesore të ndotjes së ajrit. Ata shkaktohen kryesisht nga përdorimi në rritje i automjeteve dhe shkaktimeve të tyre, si rezultat i reaksioneve kimike midis ndotësave primarë dhe përbërësve të tjerë të atmosferës. Zakonisht, për tu zhvilluar këto reaksione kanë të domosdoshme dritën e diellit, dhe si rezultat ato krijojnë smogun fotokimik, i cili është më i përhapur në zonat që kanë rrezatim diellor të konsiderueshëm. Hidrokarburet që vijnë nga shkaktimet e automjeteve dhe burime të tjera luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e ozonit në mjedisin urban.

Jo i gjithë ozoni i shtresës së ulët të atmosferës vjen prej aktiviteteve njerëzore, por ai vjen dhe nga burime natyrore dhe nga difuzioni i një pjese të ozonit nga pjesa e sipërme e atmosferës. Kushet e favorshme për krijimin e ozonit janë temperaturat e larta të ajrit mbi 32°C, rrezatim diellor intensiv dhe mungesa e reshjeve të shiut.

## **Zhurmat**

Nuk ka as monitorim te nivelit te zhurrmave ne zonen ne vlersim, monitorimet jane kryer per disa pika te qyteteve kryesore duke gene se keto qytete kane ne disa pika te tyre trafik te renduar dhe zhvillime dinamike ne fushen e ndertimit te objekteve te banimit. Zhurmat jane nje problem i zakonshem urban dhe me problematike ne segmentet me me shume qarkullim dhe trafik te renduar. Ndersa per kete zone nuk jane nje problem, kjo zone nuk konsiderohet si e zhurmshme, konsiderohet si nje nder zonat me te geta, me me vlera rekreacioni dhe me peizazh te mrekullueshem.

Në zonat rurale situata akustike është shumë më e mirë. Si problematikë paraqiten lavatriçet që funksionojnë në pjesën e poshtme të basenit ujqor të Devollit në lidhje me aktivitetin kohor dhe teknologjinë e tyre.

## Studimi i Gjendjes së Cilësisë së Ujërave Siperfaqësore

Nuk ka studime per gjendjen e cilësisë së ujërave sipërfaqësore të zonës.

Vlerësimi i cilësisë së ujërave është bërë për lumenjtë Drin, Buna, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjose është kryer në bazë të rezultateve të parametrave fiziko-kimike (temperatura, transparencë, pH, alkalinitet, perçelshmëria elektrike, Oksigjeni i tretur, NKO, NBO<sub>5</sub>, nitritet, nitratet, amoniaku, Protal) bërë në 18 stacione.

Sipas analizave të vlerësimit të gjendjes së trupit ujor, kryesisht të lumit Devoll si pjesa më furnizuese e lumit Seman (gjatësia 281 km dhe pellgu ujëmbledhës 5649 km<sup>2</sup>) me 60% të volumit të tij, me sasi të lëndës së ngurtë të transportuar 31.2 milion ton/vit, me shkallë mineralizimi 390 mg/l dhe temperaturë që luhet nga 6.8°C – 25.5°C, por dhe të arterieve të tjera që impaktojnë mjedisin hidrik të zonës sikurse lumi Shkumbin dhe Gosima që përbëjnë fluentin ujëmbledhës të pothuajse tërësisë hapësimore të bashkisë Cerr, rezultojnë se gjendja paraqitet si më poshtë:

Erozioni i tokës bujqësor në pjesën Gosimë-Mollas është i ndjeshëm.

Lartësia mesatare e pellgut të lumit Devoll 950m. Toka të imta kafë që shtrihen nga lartësia 119-600-700m, tokat e kafenjtë 700-1000m, tokat e murme pyjore 1000-1600m dhe tokat livadhore mbi 1600m. Sipas DKU lumi Devoll bën pjesë në tipologjinë e lartësisë “*Y lartë*” mbi 800m, dhe tipologjinë e masës së shtrirjes “*E madhe*” 1000-10,000km<sup>2</sup>, si dhe ekorajonin e V (Ballkani Perëndimor) (WFD 2000/60/EC).

Kjo kërkim që:

- Të kontrollohet shfrytëzimi i inerteve në këto segmente bazuar në matje dhe vlerësime periodike;
- Të largohen të gjitha impiantet e shfrytëzimit lumor nga shtrati dhe taracat lumore ;
- Të ndërtohen prita anësore dhe tërthore për të eliminuar erozionin e mëtejshëm, rehabilitimin e zonave të dëmtuara dhe mbrojtjen e ujërave;
- Të ndërpritet çfarëdolloj hedhje e pakontrolluar në shtratin e lumit (e ngurtë apo e lëngët) si dhe të shikohet mundësia për pastrim dhe sistemi të trupave ujor;
- Krijimi i hapësirave të gjelbra për të penguar fenomenin eroziv.

Ndërsa analiza fiziko-kimik e parametrave hidrike të ujërave të rrjedhshme se:

- Përmbajtja e oksigjenit të tretur 9.5 mg/l pra e cilësisë së mirë (norma>7);
- Përmbajtja e lëndëve organike e shprehur në nevojë biologjike për oksigjen ose NBO<sub>5</sub> është përkatësisht në segmentin e lumit Shkumbin për shkak të shkarkimeve konsiderohet i cilësisë së tretë, ku dhe kemi dedhjet urbane të qytetit, pra gjendje e moderuar, ndërsa në pjesën e Lumit Devoll që përkon me bashkinë Cërrik konsiderohet e cilësisë së dytë;
- Përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen. NKO që është tregues i ndotjes kimike dhe organike për shkak të shkarkimeve të ujërave të zeza, urbane, sanitare, teknologjike me ngarkesë 6.75 mg/
- Përmbajtja e fortorit total është 0.063mg/l duke qenë vlerë në normë dhe ujjrat konsiderohen të cilësisë së mirë;

- Përmbatja e nitriteve është për lumin Shkumbin 0.016mg/l duke pësuar një rritje të lehtë për shkak të shkarkimeve bujqësore. Ndërsa për sa i përket rrijedhjes së lumit Devoll vlerësohet 0.025-0.031 pra ujë i cilësisë shumë të mirë;
- Përmbatja e NH<sub>4</sub> (amoniaku) është në rrijedhjen e lumit Shkumbin 0.105 mg/l, pra është ujë i cilësisë së dytë, gjendje e mirë. Ndërsa për lumin Devoll është 0.13 mg/l, vlerësuar para bashkimit me Semanin duke u cilësuar si ujë i cilësisë së dytë me gjendje të mirë;
- Përmbatja e nitrateve NO<sub>3</sub>, për të dy lumenjtë Shkumbin dhe Devoll, vlerësohet i cilësisë shumë të mirë nën normën e lejuar <0.8 mg/l;

Duke e marrë në konsideratë pikat e monitorimit dhe duke vlerësuar në mënyrë referuese dhe krahasuese segmente e tjera lumore mund të konstatojmë se lumi Shkumbin paraqitet i cilësisë së Tretë ndërsa lumi Devoll në pjesën e sipërme (deri në Gostimë) vlerësohet i cilësisë së dytë, ndërsa pjesa e poshtme e cilësisë së tretë. Ndërsa të gjitha burimet ujore të mësipërme vlerësohen të cilësisë së parë, pra shumë të mirë. Pra në tërësinë e tyre trupat ujore rrijedhëse kanë tendencë cilësore të moderuar, çka konsiderohet si një nga problematikat e ndjeshme mjedisore, të vlerësuara domosdoshmërisht në PPV e bashkisë Çërrik.

Ujrat nëntokësore janë më të ekspozuara potencialisht ndaj ndotësve për shkak të strukturës gjeologjike, aftësisë infiltruese, mungesës së shtresës ekranizuese, shkarkimeve urbane, bujqësore dhe blegtoriale të pakontrolluara por dhe të vendndodhjes së aktiviteteve impaktuese pa studime hidrogeologjike paraprake. Sipas analizave të elementëve kimik dhe anioneve e kationeve vlerësuese ujrat nëntokësore të zonës konsiderohen shumë të mirë.

Lumi Devoll buron nga shpatet jug-lindore të maleve të Moravës. Ai është 196 km i gjatë. Sipërfaqja e ujëmbledhësit është 3139 km<sup>2</sup> dhe lartësia mesatare 960 m mbi nivelin e detit. Prurja mesatare e Devollit është 49.5m<sup>3</sup>/sec. Ushqehet kryesisht nga ujra sipërfaqësore. Mineralizimi i ujit është 390 mg/l.

River, station	Dissolved oxygen, mg/l	COD mg/l	BOD mg/l	Ammonium mg/l	Nitrate mg/l	Silica mg/l	P <sub>tot</sub> mg/l
Shkumbini 1	8.32	0.52	1.11	0.092	1.20	18.0	0.11
Shkumbini 2	6.69	1.20	4.30	0.30	0.70	23.0	0.10
Devoll	7.77	1.88	1.78	0.05	0.70	13.0	0.03
Osumi	6.29	3.20	5.06	0.13	0.50	20.0	0.05
Semani	8.80	1.76	3.21	0.05	0.52	27.0	0.03

Shënim: Në tabelë janë paraqitur të dy lumenjtë, përkatësisht Shkumbin dhe Seman degë e të cilët është Devollit pasi shtrihen ose kufizojnë territorin e bashkisë së Çërrikut

Ndërkohë që zonat që përskohen nga rrijedhjet lumore të Lumit Devoll (zona e Klosit dhe Mollasit që janë mjaft aktive në fushën e prodhimit bujqësor) por dhe të Gostimës, vërehet shtim të eutrofizimit të lidhur me regjimin hidrik të tyre, me shfrytëzimin e inerteve dhe depozitimin e tyre pa asnjë kriter hidrogeologjik, me depozitimin e mbetjeve organike në mënyrë spontane, madje agresive për regjimin ujor duke ndikuar në pakësimin e përmbatjes së O<sub>2</sub> në këto mjedise.

#### IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

#### Lloji i ndikimeve të identifikuarra (direkte dhe jo direkte)

Vlerësimi i ndikimeve në mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm;
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake;
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore;
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit;
- Parimi i qasjes së integruar;
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit;
- Parimi “Ndotësi paguan”;
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut;
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.

Ky vlerësim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndlkimit ne Mjedis” dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndlkimit ne mjedis” dhe ka si synim idneifkimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojte te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e demtimi. Kjo perben perparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

**Ndlkime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.**

***Efektet negative ne mjedis.***

Potencialisht, gjate aktivitetit te kantines mund te hasim ne efekte negative ne mjedis si:

Ndotja sipërfaqesore dhe e ujrave nentokesore si pasoje e difekteve te mundeshme ne rjetin e shkarkimeve te ujrave te zeza dhe te bardha.

Ndotja e mjedisit si pasoje e zhurmave qe mund te shkarkohen nga motorat dhe burite e makinave.

Ndotje te tokes nga derdhja e karburanteve dhe lubrifikanteve

Ndotja e mjedisit nga mbeturinat e ngurta.

Ndotje e ajrit.

***Ndlkimi ne sipërfaqe dhe ujrat nentokesore.***

Vektoret kryesore te mundeshem te ndotjes se sipërfaqes dhe ujrave nentokesore jane kanalizimet e ujrave te bardha dhe te zeza. Per rjedhoje reziku i ndotjes mund te vije nga fekalet dhe elementet ndotes te detergjenteve qe perdoren per pastirimin e ambienteve, makinerive, eneve, te tualeteve e tj.

### *Ndikimi ne ajer.*

Megjithese praktikisht nuk ka rezik, ndotja e ajrit mund te vije nga djegja jo e rregullt e karburantit te makinave..

### *Zhurmat*

Ne mjedisin perreth mund te behen problem shqetesues zhurmat qe vijne si rezultat i i rrites se fluksit te makinave, i manovrimit dhe i burteve.

Persa i perket zhurmave qe vijne si rezultat i aktivitetit, ato jane minimizuar si rezultat i investimeve qe jane kryer.(jane pershkruar me lart).

### *Rastet aksidentale*

Zjaret mund te jene te pranishem

Aksidente

Te tjera te paparashikuara.

## **4. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.**

**Shkarkimet e ujrave-** Ky aktivitet nuk ka shkarkime industriale ne uje. Ujerrat qe perdoren jane vetem ato te ambienteve higjieno-sanitare perfsihi edhe ujerat e lajtes se eneve te depozitimit dhe te fermentimit te rrushit. Procesi i fermentimit dhe i prodhimit te veres nuk shogerohet me shkarkime te ujerave te perdorur.(Bersite e rrushit kullojne leng ne rast se nuk ruhen dhe menaxhohen sic duhet).

**Emetimet ne ajer** mund te vijne nga aroma e bersive, gjate procesit te hapjes se fucive per kontroll dhe perzierje te rrushit ne proces fermentimi e sipër. Kjo arome nuk vleresohet ne nivele problematike per ambientin e lokalit dhe per fqinjët. Aroma e bersive ne rast se depozitohen dhe lihen per dekompozim aty mund te jete nje shqetesim serioz per banoret. Bersite e rrushit nuk duhet te asgjeshohen ne ambientin e prodhimit, por duhet te largohen dhe perdoren per pleh organik per pasurimin e tokave bujqesore.

**Zhurmat-** Ky aktivitet nuk shogerohet me zhurma ne mjedis. Nuk ka as pajisje as makineri me elektromotorre apo lende djegese,nuk prodhohen zhurma.

**Toka-**Nuk ka ndikim ne toke, pasi aktiviteti funksionon ne nje ambient te mbyllur dhe te izoluar me beton nga toka. Nuk ka punime ne toke, nuk ka shkarkime ne toke.

**Ndikimi ne Biodiversitet-** Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e ndjeshme te zonave te mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitet. Aktiviteti ndodhet ne brendesi te zones urbane, te vijes se verdhje te fshatit.

**Ndikimi ne Mjedisin Social-** Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, do te jete pozitiv persa i perkete punesimit, sherbimit te prodhimit e shiftjes se VERES me gmime dhe cilesi te konkureshme. Subjekti duhet te respektoje reptesisht ligjet ne fuqi te shiftjes se alkooolit ku ka detyrimin te mos e shes nen moshat 18 vjec.

**Mbejftet e prodhuara-** Mbejftet e ngurta qe do te prodhohen do te jene ato te bersive te rrushit dhe mbejfte urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbejfte te ngurta te rezikshme, pasi bersite jane mbejfte organike dhe 100% te riciklueshme. Subjekti duhet ti menaxhoje bersite duke i depozituar ne nje grope te caktuar ne tokat bujqesore dhe larg banesave, duke i dekompozuar ato dhe duke i perdorur per pleherim organik. Keto bersi, si pleh organik, pasurojne token me emente ushqyesh natyral, duke shrangur

keshtu jo vetem kostot e pleherimit kimik, por edhe ndodjen e mjedisit bujqesor dhe ruajtur konstant cminim e produktit.

## **5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.**

Ndikimi i aktivitetit ne kushte normale funksionimi do te zgjase per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti, pra vetem gjate sezonit te prodhimit te rrushit dhe perpunimit te tij e prodhimit te veres (pra nga 1 deri ne 2 muaj ne vit).

## **6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS**

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, mbetet vetem brenda ambientit e prodhimit e ambalazhimit te pjeteve alkoolike. Nuk vleresohet aktivitet me ndikim me shtrirje hapësinore, kjo per vete faktin se nuk ka shkakime te demshme ne ajer, ne uje apo ne toke.

Menaxhimi i bersive, kerkon nje proces dhe nje menyre profesionale menaxhimi, duke i shnderruar ato ne nje pleh organik me vlera per bujqesine e zones dhe jo duke i shnderruar ato ne mbejte te cilat kane kosto menaxhimi e asgjesisimi.

## **7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.**

Nga ana jone si subjekt investitor, do te te kujdesemi per nje mjedis te pastër, te rregullt, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per mjedisin. Mjedisi i ketij aktiviteti eshte me funksion prodhim vere dhe si rjiedhoje duhet te zbaroje kushte te larta higjienke. Mjedisi ku zhvillohet aktiviteti eshte ambient i subjekti , brenda teritori te familjes. Lidhur me rehabilitimin per ta kthuer ne gjendjen e meparshme ne rast mbyllje te aktiviteti nuk ka probleme, sepse ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, mbetet vetem brenda ambientit e prodhimit e ambalazhimit te prodhimit te vere. Nuk vleresohet aktiviteti me ndikim me shtrirje hapësinore, kjo per vete faktin se nuk ka shkakime te demshme ne ajer, ne uje apo ne toke objekti nuk ka zene toke buke, por eshte godime e cila kthehet ne mjedis tjeter familjar.

## **8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGJEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.**

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori ose qeramarresi per mbarefunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit fizik e biologjik.

- Mbejdet e ngurta(bersite) e rrushit, te menaxhohen ne menyre te integruar duke u perdorur per qellime bujqesore dhe ne asnje menyre te mos hidhen ne konteneret e mbejteve urbane te zones.
- Ne ambient te ruhen kushte te larta higjienike te prodhimit te produktit ushqimor, vere e raki
- Te prodhohet produkt cilesor dhe ne asnje menyre te mos perdoren ingrediente, ngjyrtues apo substanca te tjera artificiale te cilat mund te ndikojne negatvisht ne shendetin e konsumatoreve.
- Subjekti te ruaj parametrat e lejuar te elementeve perberes te veres.
- Fortesia dhe gradat e alkoolit te respektoje normat e lejuara per konsum per popullsinë.

## **9. NDIKIMET E MUNDSSHME NË MJEDISIN NDERKUFTAR (NËSE PROJEKTIKA NATYRË TË TILLË).**

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit nderkuftar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit të shteteve fqinje, madje në kushte normale, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkuftare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin nderkuftar. Për këtë kapital, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distanca që ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.

## **10. MONITORIMI**

Monitorimi i cilësive së mjedisit dhe i nivelit të elementeve ndotes të tij, shkaktonet në ajër, në ujë, në toke dhe dëmtimi i mjedisit biologjik, kryhet sipas disa kriterëve shkencorë persë i perket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizimit të mostrave të ujit dhe të tokës, ndërsa persë i perkete ndotjes së ajrit ai monitorohet direkt në terren. Procesi i monitorimit synon mbledhjen e të dhënave të nevojshme për të vërtetuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesorë të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione midis lidhjes së kushteve të burimeve të ndotjes dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësine e mjedisëve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor ose ekonomik, me synim për të marrë masat e nevojshme për reduktimin e shkarkimeve dhe përmirësimin e cilësive së elementeve të mjedisit.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore të hartuara dhe të ndërmarrta.

Procesi i monitorimit në rang individual, sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit, është detyrë e shogerisë investitore ose e nenkontraktorit për elementet në të cilat ai ndikon. Sipas VKM Nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit” pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 mund të monitorohen nga vetë investitori.

Investitori, mund të monitorojë keto treguese të trysnise në mjedis gjatë funksionimit të aktivitetit:

- Për ajrin nuk rekomandojme monitorimsepse punohet me energji elektrike dhe me panelle diellore.
- Për ujin, vetëm gjatë procesit të prodhimit, pra depozitimit të bersive, sipas legjislacionit rekomandohe: pH, LNP, BOD<sub>5</sub>, COD.
- Për token, nuk rekomandojme monitorime.

Frekuenca e monitorimeve do të percaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit. Rekomandojme që raportimi të kryhet nepërmjet një relacioni shkresor periodik ku të pasqyrohen proceset e punës të kryera gjatë kesaj periudhe të shogëruara me foto dhe masat e marra deri në momentin e raportimit në lidhje me reduktimin e ndotjes, menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit, kjo sipas percaktimeve në ligjin e vjetër për mbrojtjen e mjedisit, i shfuqizuar pjesërisht.

Per kete instalim, aspektet mjedisore negative konsistojne ne prodhimin e mbejtjeve te ngurta te bersive te rrushit. Keto mbejtje nese menaxhohen ne menyren e duhur nuk perbejne problem as per mjedisin, as per shendetin, madje ka perfitime te mira ekonomike.

Menyra e menaxhimit e tyre eshte jashte instalimit dhe mendohet te realizohet ne kete menyre: do te behet Transportimi dhe depozitimi i tyre ne nje ambient te pershtatshem per riciklimin e tyre nepermjet biodegradimit, dekompozimit te lendes organike dhe prodhimit te plehut organik per bujtisi. Vendi ku do te depozitohen do te percaktohet ne nje faze te mevoneshme. Do tu jepen fermereve te zones qe ti menaxhojne ata per nevojat e tyre. Riciklimi i mbejtjeve biologjike, eshte me kosto te ulet por me vlere te larte perfutuese pasi pleherohet toka me elemente ushqyes organike dhe minerale, duke shmangur ose reduktuar pleherimin kimik dhe duke ulur rezikun e ndotjes se mjedisit bujqesor. Pleherimi i vreshtave me keto lloj mbejtesh organike, eshte i pershtatshem, pasi i rikthehen tokes ne vija te pergjithshme te njejtat elemente ushqyes qe bima e rrushit merr dhe qe ka nevojte per te siguruar nga toka.

Ne kete aktivitet gjenerohen Mbejtje qe vijne nga larja, pastrimi dhe përpunimi mekanik i lëndëve të para me kodin 02 07 01, si edhe Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim qe identifikohen me kodin 02 07 04. Menyra e menaxhimit e tyre eshte jashte instalimit dhe mendohet te realizohet ne kete menyre: do te behet Transportimi dhe depozitimi i tyre ne nje ambient te pershtatshem per riciklimin e tyre nepermjet biodegradimit, dekompozimit te lendes organike dhe prodhimit te plehut organik per bujtisi. Vendi ku do te depozitohen do te percaktohet ne nje faze te mevoneshme. Do do tu jepen fermereve te zones qe ti menaxhojne ata per nevojat e tyre. Riciklimi i mbejtjeve biologjike, eshte me kosto te ulet por me vlere te larte perfutuese pasi pleherohet toka me elemente ushqyes organike dhe minerale, duke shmangur ose reduktuar pleherimin kimik dhe duke ulur rezikun e ndotjes se mjedisit bujqesor. Pleherimi i vreshtave me keto lloj mbejtesh organike, eshte i pershtatshem, pasi i rikthehen tokes ne vija te pergjithshme te njejtat elemente ushqyes qe bima e rrushit merr dhe qe ka nevojte per te siguruar nga toka.

Mbejtjet urbane grumbullohen dhe hidhen ne kontenierin e mbejtjeve te ngurta urbane, ku pastrohen cdo dite nga firma pastruese e zones.

Mbejtje te ngurta urbane, me kodin 15 01 (Mbejtje te ngurta urbane.). Prodhimi i tyre ne objektin e zyrtave, sasia deri 4 Kg/dite, kur punohet, menaxhimi i tyre Depozitim ne kontenierin e mbejtjeve te ngurta urbane te zones.

**Kimist Teknolog Begir Kila**  
**Administratorja e subjektit**

**Floreta Sade**